

Investitori: "Lab Oil" sh.p.k. Prishtinë
Lokacioni: Preoc, Graçanicë

RAPORT
I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
Për Fabriken e Pet Kokut në Preoc dhe impiantit për
deponimin e pet Kokut



Dhjetor , 2023

Numri i projektit	5/2023	Dhjetor -2023
Investitori :	„Lab Oil „Sh.p.k.Prishtine Drejtor: Berat Ahmeti v.v.	
Emërtimi i projektit:	RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS Për Fabriken e Pet Koksit Preocë dhe impiantit për deponin e pet koksit	
Lokacioni :	z.k. Preoc , KK.Graçanicë	
Hartimi i projektit: Personi fizik i licencuar	Dr.sc.Selim Frangu ing.dipl. i gjeol.	
Bashkpunetor:	Dr.sc.Musa Shabani ing.dipl. i gjeol. Msc.Leutrim Frangu Hidrogjeologji- Gjeologjia inxhinierik	

Përmbajtja

1.Hyrje	4
Baza për Hartimin e Raportit	7
2.1. Rregullativa ligjore	7
3. Karakteristikat e Lokacionit dhe Mjedisit.....	10
3.1. Pozita gjeografike e lokacionit.....	10
3.2. Popullata dhe Vendbanimet	13
3.3. Lidhjet e Komunikacionit	14
3.4. Kushtet klimatike	14
3.5. Hidrogjeologjia	15
3.6.Relievi	16
3.7. Pedologjia	16
3.8 Natyra dhe biodiversiteti.....	17
3.9. Flora dhe Fauna.....	17
3.10. Dukshmëria	18
3.11. Peizazhi	18
3.12. Ajri	18
3.13. Uji	18
4.2. Koncepti prodhues i fabrikes se peti koksit	29
5. Identifikimi dhe Përshkrimi i Ndikimeve të Mundshme ne Mjedis	30
5.1. Ndikimet në ajër	37
5.2. Ndikimet në tokë.....	37
5.3. Ndikimet në ujë.....	38
5.4. Ndikimi në Peizazh	38
5.5. Ndikimi në florë dhe faunë	39
5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	39
5.7. Ndikimet nga Zhurma	39
5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore.....	40
6. Marrja e Masave për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Ndikimeve	41
6.1. Masat e marura për mbrojtjen e ajrit	41
6.2. Masat e marura për mbrojtjen e tokës.....	41
6.3. Masat e marura për mbrojtjen e ujit.....	42
6.4. Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma	44
6.5. Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale	44
7. Programi i monitorimit	44
8. Raportimi	45
9.0. Masat Rehabilituese pas Përfundimit të Aktivitetit Prodhues	45
9.1. Objektivat e rikultivimit	45
9.2. Struktura përfundimtare e sipërfaqeve.....	46
9.3. Rikultivimi teknik	46
9.4. Rikultivimi agroteknik	46
9.5. Rikultivimi biologjik.....	47
10. Konkluzion.....	48

1.Hyrje

Në kuadër të aktiviteteve për marrjen e Pëlqimit Mjedisor për **Fabrikën e Pet Koksit dhe impiantit për deponimin e koksit , Çagllavicë** , Berat Ahmeti, nga Prishtina Drejtor i kompanisë „**Lab Oil,,Sh.p.k. Prishtine**, ka bërë përgatitjet e dokumentacionit për fillimin e hartimit të Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të **Për Fabriken e Pet Koksit dhe impiantit per deponimin e koksit në Çagllavicë, Graqanicë** në ngastrën kadastrale, të njesisë kadastrale P-73414058-00590-3 zona kadastrale Preoc , parcell, prone private e Zones,, R” vendi i quajtur Fusha e Gjere me sipërfaqe $S= 8976 \text{ m}^2$, tokë ndërtimore , pjesë e pronës I/I e azhuruar me datën 19.03.2014 e leshuar me datën 19.04.2022, ndërsa në ngastrat kadastrale P-73414058-00592-10 me siperfaqe $S=10701 \text{ m}^2$ toke bujqesore kl.3 e azhuruar 13.10.2017, P-73414058-00591-2 me $S=7336 \text{ m}^2$ toke bujqesore kl.3 e azhuruar 14.04.2017 dhe P-73414058-00591-3 me $S= 4146 \text{ m}^2$ toke bujqesore kl.3 e azhuruar 14.04.2017, do të shfrytëzohen per deponimin e koksit, ngastrat e mesiperme jane kthyer nga toke bujqesore ne ate ndertimore nga **Departamenti per Planifikim Urbanizem, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit të qytetareve** të Komunes së Graqanices sipas numrit të protokolit II779/16 e datës 16.03.2016. „**Lab Oil,,Sh.p.k. Prishtinë**, gjithashtu ka marre leje ndërtimi të objektit në ngastrën 1699/1 z.k. Lapla sele me numer te protokolit II550/22 e dates 29 .06. 2022 me siperfaqe 1835.25 m^2 nga **Departamenti i urbanizmit, planifikimit dhe mbrojtjes se mjedisit ne Graqanice , ku kompani parasheh të beje deponimin e pet koksit**. Raporti i VNM-së paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor. Me qëllim që të identifikohen dhe analizohen ndikimet në mjedis të tërë veprimtarisë së Fabrikes se Pet Koksit duke i parashtruar dhe ndërmarr masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokacionin ku ushtrohet kjo veprimtari. Në raportin e VNM-s duhet analizuar karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin e Fabrikes se Pet Koksit si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse, nga njëra anë, dhe karakteristikat inzhinjeroko- teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër, shtrohet nevoja për hartimin e Raportit të VNM-së ku do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin Fabrikes se Pet Koksit dhe impiantit per deponimin e koksit dhe mjedis, duke mos anashkaluar edhe ndikimet kumulative në regjionin më të gjerë. Duke u nisur nga qëllimi paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky Raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për tu marr për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative.


Me rastin e hartimit të Raportit janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë realizimit të procesit teknologjik të prodhimit të Pet Koksit dhe impiantit per deponimin e koksit, dhe pas përfundimit të projektit, kurse për fazën e ndërtimit nuk është marr për bazë, sepse në kohën kur është hartuar ky raport ka qen e përfunduar faza e ndërtimit të Fabrikes se pet Koksit dhe impiantin e deponimit te lendes se pare per prodhimin e pet koksit, ku gjendet edhe depoja e karboranteve te Naftes dhe Benzines ne te cilen kompania posedon pelqimin mjedisor, gjithashtu ne ngastren e lartecekur gjate punimit te raportit te vnm-se per depon e karboranteve te naftes dhe

benzines ka qen depoja e perkohshme e koksit e cila ka qen e perfshir ne raport te vleresimit te ndikimit ne mjedise. Meqenese Fabrika e pet koksit me dy linja te prodhimit dhe deponimi i koksit eshte ndertuar me pas , ne po punojm edhe kete raporte te vleresimit te ndikimit ne Mjedis per kete fabrik me qellim te marrjes se pelqimit mjedisor.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
 MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
 AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY
 KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GRACANICA
 Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Preoc



Shkalla/Razmera/Scale: 1:3199

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 19.04.2022

Koha/ Vreme/ Time: 10:05:00

Nënshkrimi/Potpis/Signature: *M. Hekati*

Shënim/Beleška/Note: Na parcelama je registrovana hipoteka.

Aprovui/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature: *B. Lleshi*





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GRACANICA
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Preoc

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-73414058-00590-2	Parcelë / Parcela / Parcel	1280
P-73414058-00590-3	Parcelë / Parcela / Parcel	8976
P-73414058-00590-4	Parcelë / Parcela / Parcel	1690
P-73414058-00590-5	Parcelë / Parcela / Parcel	1350
P-73414058-00592-14	Parcelë / Parcela / Parcel	232
P-73414058-00592-10	Parcelë / Parcela / Parcel	10701
P-73414058-00591-2	Parcelë / Parcela / Parcel	7336
P-73414058-00591-3	Parcelë / Parcela / Parcel	4146

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 19.04.2022

Koha/ Vreme/ Time: 10:05:00

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note: Na parcelama je registrovana hipoteka.

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Baza për Hartimin e Raportit

Analiza përfshin projeksionin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti ambiental gjatë funksionimit kontinuel të fabrikes se pet koksit edhe atë :

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- vlerësimin e ndikimit në mjedis
- propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin gjer në kufijtë e lejuar.

2.1. Rregullativa ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Legjislacioni ne lidhje me ruajtjen e mjedisit është ne përputhje me normativat evropiane te mbrojtjes se tij ndonëse cilësia mjedisore është ende ne parametra mjaft te ulet. Ligji i pare për mbrojtjen mjedisore ne Kosovë daton ne vitin 2003 dhe shprehet se te gjitha veprimtaritë e personave fizike dhe ligjor, vendas apo te huaj, qe ushtrojnë veprimtari të reja , do te jene temë e vlerësimit të ndikimit ne mjedis. Ne lidhje me vlerësimin e ndikimit ne mjedis – VNM është aprovuar Ligji për VNM (Nr. 03/L-214) i cili përcakton te gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim te VNM. Ligji për VNM (Nr. 03/L-214) ka për qellim për te siguruar mundësimin e një vlerësimi te përgjithshëm me ndërthurje te ndikimeve mjedisore te projekteve apo veprimtarive qe do te realizohen me qellim qe te parandalojnë dhe te zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative ne mjedis ne kohen e duhur.

Ligjet dhe aktet nënligjore me te rëndësishme te aplikuara për hartimin e VNM-së për projektin për prodhimin e betonit janë si me poshtë:

➤ Ligjet

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 08/L-0181
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji Nr.08/L-071 Per ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit nr. 04/L-060 per Mbeturina
- Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri

- Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 03/L-160
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233
- LIGJI_Nr._04_L158_PËR_NDRYSHIMIN_DHE_PLOTËSIMIN_E_LIGJIT_NR._03_L163_PËR_MINIERAT_DHE_MINERALET

Udhëzimet Administrative

- Udhëzimi administrativ (QRK)-Nr.03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat per eliminimin e pasojave;
- Udhëzimi administrativ (QRK) Nr.08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave;
- Udhëzimi administrativ Nr. 02/2019 për export, import dhe transit të mbeturinave;
- Udhëzimi administrativ Nr. 01/2017 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës;Udhëzimi administrativ Nr.30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujrave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor;
- Udhëzimi administrativ Nr. 04/2018 për Pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme. *Udhezimi administrative (QRK)- nr. 03/2021 per menaxhimin e mbeturinave te rrezikshme*
- Udhëzim Administrativ Nr,07/2021 per rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajr nga burimet e pa levizshme te ndotjes.
- *Udhëzim Administriv (MMPHI) Nr. 02/2022 per kushtet , menytrat ,parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit te ujerave te ndotura ne rrjetin e kanalizimit public dhe trupin ujqor.*

b) dokumentacioni teknik

Gjatë hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përpos eksperiencës profesionale ne udhëheqjen e procesit teknologjik për fabriken e petk koksit dhe

konsultimeve që janë bërë me ekspertët që udhëheqin procesin teknologjik, janë shfrytëzuar:

1. Projekti kryesor i ndërtimit të fabrikes se petk koksit
2. Projekti kryesor teknologjik i fabrikes se petk koksit
3. Qertifikata e biznesit
4. Fleta poseduese
5. Kopja e planit të parcelës.
6. Pelqimi komunal

Krahas parashikimeve themelore nga regullativat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hartimit të raportit të VNM-s për rastin konkret janë shfrytëzuar edhe regullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi. Duke u nis nga fakti se një pjesë e madhe e mardhënjeve specifike nga lëmia e mjedisit nuk është përfshirë në rregullativat ligjore të tanishme prandaj për nevoja të hartimit të këtij raporti të VNM-s është shfrytëzuar përvoja e mirë dhe rregullat relevante ndërkombëtare, si dhe direktivat përkatëse për mjedis si që është direktiva e VNM-s (85/337/EEC).

2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për fabriken e pet koksit bëhet në disa faza edhe atë:

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet si që janë :

- burimet themelore të ndikimeve në mjedis.
- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- karakteristikat e dheut , topografia dhe peizazhi në lokacionin ku është e ndërtuar ndërtuar Fabrika e Pet kokut.
- klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike.
- kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë.
- bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve

- madhësia dhe lloji i ndotjes
- karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse

c) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin e fabrikes pet kokstit dhe deponis.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kvantifikimit dhe vlerësimin të gjendjes ekzistuese.

Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që ka të bëjë me potencial të shprehur ekologjik . Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3. Karakteristikat e Lokacionit dhe Mjedisit

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren . Për të u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

3.1. Pozita gjeografike e lokacionit

Fabrika e Pet Koksit me deponin dhe objekteve përcjellëse e kompanisë "Lab-Oil" Shpk ndodhet në pjesën qendrore të Kosovës 5 km në jug të Prishtinës ndërmjet fshatit Laplasell dhe QMI në pjesën perendimore të autouidhës Prishtinë – QMI në anën e majtë të hekurudhës që ndërpret këtë autouidhë në drejtim të fshatit Marigona. Ndërmarrja ka selinë në objektin i cili shtrihet në ngastrat kadastrale të zones kadastrale Preoc, komuna e Graqanicës në vendin e ashtuquajtur Fusha e gjere , ngastra (pjesë) 590-3 me sipërfaqe $S=8976m^2$ ku është i vendosur Fabrika e petkoksit ndërsa deponimi i pet koksit në ngastrat 0592-10, 0591-2 dhe 0591-3 zona kadastrale Preoc, kk.Graqanicë dhe me pas pretendohet që ky deponim i pet koksit të bëhet në ngastren kadastrale 1699/1. Shpk "Lab-Oil" ka marrë **leje ndërtimi të objektit në ngastren 1699/1 me sipërfaqe 1835.25m² z.k. Lapla sele me numer të protokolit II550/22 e datës 29 .06. 2022 nga Departamenti i urbanizmit, planifikimit dhe mbrojtjes së mjedisit në Graqanice. Lab Oil parasheh të bëjë deponimin e pet koksit .**

Këto ngastra i përkasin zonës kadastrale PREOCE me shfrytëzues SHPK „LAB OIL ” , kopja e planit e leshuar ne Graçanicë e datës 19.04.2022, Komuna Graçanicë e përshkruar ne emer të biznesit „LAB-OIL” SHPK me nr. biznesi 70623331, selia ne Prishtinë, rruga Agim Ramadani Prishtinë.

Ngastra ku eshte ndertuar fabrika eshte e njesisë kadastrale P-73414058-00590-3 zona kadastrale Preoc , parcell, prone private e Zones,, R” vendi i quajtur Fusha e Gjere me sipërfaqe $S= 8976 \text{ m}^2$, toke ndertimore , pjesë e pronës I/I e azhuruar me datën 19.03.2014




Fig.2.Pozita gjeografike e Fabrikes se pet kosit (me koordinatat kufizuese)

Lokacioni ku gjendet fabrika e pet koksit te shpk “ LAB OIL” shihet në pjesën e hartës topografike të më sipërme.

Në afërsi të drejtpërdrejt të lokacionit ku do të bëhet prodhimi i pet koksit nuk ka objekte banimi, objektet më të afërta të banimit janë ne një largësi mbi 800m, te gjitha objektet qe jane afer Shpk” Lab-Oil” jane afariste. Këto vlerësime shërbejnë si bazë për kuantifikimin e ndikimeve të mundshme dhe për përcaktimin e masave të nevojshme mbrojtëse duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një lëmi specifike për prodhimin e pet koksit per te vleresuar ne ndikimet kumulative të ndotjes.

Lokacioni ku do të kryhet operimi i prodhimit të pet koksit është kuota mbi 500m dhe më e ultë është 450m..

Relievi në përgjithësi është fushor gjegjësisht tokë bujqësore e transferuar ne toke ndertimore. Te punesurit ne keto kompani afariste jane banor te regjioneve te aferta apo te fshatrave per rrethn dhe nga qytetet e Kosoves, sikurse edhe ka te punësuar edhe në fabrikën e pet koksit, dhe në depon karborantit , kurse një pjesë e popullatës merret me blegtori. Lidhjet me komunikacionin rrugor janë mjaftë të mira ,fabrika lidhet me rrugën e asfaltuar Prishtin –Ferizaj dhe Prishtine -Lipjan dhe me të gjitha pjesët e Kosovës..




Fig.3 Imazhi paraqitjes se fabrikes se pet koksit shpk” LAB OIL” PRISHTINE




Fig.3a Fabrika e pet-kokut me deponin

3.2. Popullata dhe Vendbanimet

Komuna e Graçanicës është themeluar në pajtim me planin e Marti Ahtisaarit nëpërmjet përfshirjes së pjesëve të komunave të Prishtinës, Lipjanit dhe Fushë Kosovës. Komuna e Graçanicës përfshin vendbanimet dhe njësitë kadastrale si në vijim: - nga komuna e Fushë Kosovës: Batushë dhe Uglar; - nga komuna e Lipjanit: Gushterice e Epërme, Dobratin, Gushterice e Poshtme, Lepina, Livagje, Radeve, Skulaneva dhe Suvi Do, - nga komuna e Prishtinës: Graçanica, Badoci i Ri, një pjesë nga Badoci i Vjetër, Llapnasella, Sushica, Preoci, Kishnica dhe një pjesë e Çagllavicës. Komuna e Graçanicës është themeluar në pajtim me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave të miratuar më 20 shkurt 2008. Pasuar nga zgjedhjet e 15 nëntorit të vitit 2009, Komuna e Graçanicës është themeluar zyrtarisht më 29 dhjetor 2009.

Territori i komunës mbulon një sipërfaqe prej 122,25 km².. Te dhenat e prezentuara me poshte jane marruar nga anketea e ekonomive familjare, e realizuar nga Komuna e Graçanicës. Komuna e Graçanicës ka 25,000 banorë me strukturë shumetnike, nga të cilat 85.7% serbë, 3.7% shqiptarë dhe 10,6% romë, ashkali, egjiptas dhe të tjerët. Me vendndodhjen e saj të përshtatshëm, d.m.th afër kryeqytetit Prishtinës, ofron mundësi të mëdha për zhvillimin e Graçanicës në tregti komerciale dhe banesore të begatë, multi-kulturore (Burimi: Plani i Veprimit i Graçanicës 2010). Me themelimin e komunës së re, banorët që banojnë në këtë zonë janë të pajisur me mundësi të mëdha për shërbime më të mira dhe përmirësimin e standardit të jetesës.

Prishtina është kryeqyteti dhe qyteti më i madh i Republikës së Kosovës. Qyteti është bashkësi dhe kryeqendra e Qarkut të Prishtinës. Bashkia e Prishtinës ka një popullsi prej 198.214 banorësh sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011. Komuna e Prishtinës përbëhet nga 43 vendbanime mes tyre qyteti kryesor i Kosovës, Prishtina.

Prej viteve të '60-ta, Prishtina përjeton një zhvillim urbanistik të hovshëm që ja ndërron dukjen nga një qytezë me tipare otomane në një qytet bashkëkohor.

Vitet e '70-ta sjellin një ndryshim thelbësor në karakterin e qytetit, të ndikuara nga hapja e Universitetit të Prishtinës dhe rritja e ndikimit politik të Prishtinës me fitimin e autonomisë dhe faktoriizimin federal të Kosovës në kuadër të shteti, ish-Jugosllavi. Në këto dy dekada ndërtohen lagjet Ulpiana, Dardania, Lakrishtja, Bregu i Diellit, Arbëria (ish-Dragodani) dhe të gjitha objektet identifikuese të Prishtinës.

Tani, Prishtina u shendrrua ne një kryeqytet te Shteti te Ri Evropian – Republikës se Kosove, pësoi një rritje ne kuptimin e avancimit politik e zgjerim te hovshëm, ne shtrirjen e tij duke shënuar rritje ne kuptimin e zgjerimit hapësinore dhe atë numerik te popullsisë, pore qe fatkeqësisht jashtë standardeve evropiane te planifikimit hapësinore dhe mjedis, perkatesishte pesoj nje degradim mjedisore.

Banorët e fshatrave kryesisht merren me bujqësi, pemëtari dhe blegtori.

Ne afërsi të drejtpërdrejt të lokacionit ku është i ndërtuar fabrika e pet kokut nuk ndodhen objekte të banimit, objektet jane objekte afariste , per gjate rruges se asfaltuar ne drejtim te lagjes Marigona. Fabrika e pet koksit në pikëpamje mjedisore nuk do të ketë ndonjë ndikim relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi sepse një numër i popullatës janë të punësuar në ketë fabrik te pet kokut për kryerjen e aktiviteteve shërbyese.

3.3. Lidhjet e Komunikacionit

Lidhjet me komunikacionin rrugor janë mjaft të mira, nga fabrika në drejtimin rrethit te magjitrates Prishtine-Ferizaj –Shkup eshte rreth 250m e cila i mundeson te lidhet me të gjitha pjesët e Republikës së Kosovës

3.4. Kushtet klimatike

Rajoni i Graçanices karakterizohet me klimë kontinentale të butë, dimër të ashpër që është normale për rajonin e mesem kodrinorë-malor. Në bazë të të dhënave të bëra nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës kemi këto parametra klimatik për këtë regjion.

Sipas klimadiagramit temperatura mesatare vjetore është $9,7^{\circ}\text{C}$, ndërsa sasia vjetore e të reshurave është 650mm/vit. Muajt më të nxehtë të vitit janë korriku me temp. $19,8^{\circ}\text{C}$ dhe gushti me temperature mesatare $19,4^{\circ}\text{C}$, ndërsa muajt ma të ftohtë janë muaji Janar me temperature mesatare -2°C . Lagështia mesatare vjetore është 55,58 %. Rrezatimi diellor mesatar vjetor është 223 orë.

Shumica e terreni është i përbërë nga sedimentet aluviale dhe delvioale te Pliocenit , ku nen keto sedimente paraqiten rreshpet Paleozoike të cilat kanë karakteristika të dobëta të çarkullimit të ujit, dhe nga gnajs granitet qe e perfaqesojn kete mjedise e të cilët mundësojnë depërtimin e ujit në këta shkëmbinj si dhe nga sedimentët e terciarit dhe

kuaternarit. Në anën lindore të vendburimit gjendet lumi Graçanka i cili derdhet në lumin e Sitnicës .

3.5.Gjeologjia

Tereni ku është vendosur fabrika e petkoksit është e perfaqësuar nga sedimentet e Kuaternarit , sedimente proluviale të vjetra të cilat janë të mbijetura mbi sedimentet e Paleozoikut, në pjesën lindore kemi shkëmbinjet vullkanik të Terciarit, andezitet.




Fig.6 Harta gjeologjike e zonës së fabrikës

3.6. Hidrogjeologjia

Ngastra ku është e vendosur fabrika e pet koksit ka karakteristika të mira hidrogjeologjike. Shtrihen në mes të shkëmbinjve me karakteristika jo ujëlshues rreshpeve biotit –muskovite (Paleozoikut). Në kete ngaster nuk kemi paraqitje të ujërave nëntokësore. Ujërat sipërfaqësorë rrjedhin anash ngastres ,kurse një pjesë e vogël nëpër çarje depërton deri ne thellesi te ketyre depozitimeve proluviale.

Ujërat sipërfaqësorë paraqiten vetëm gjatë të reshurave atmosferike, të cilat drenohen në kanalet natyrale (prrockat) dhe pastaj drenohen në pusetat e ndertuara enkas për orientimin e ujit ne pusetat ujmbledhes. Në aspektin hidrologjik ujërat sipërfaqësorë të komunës se Graçanices karakterizohen me ujera të bollshme sipërfaqësore të cilat përfaqësohen me shumë per gjate Lumit të graçanices dhe Lumit te Sinices.



Fig.7.Harta hidrogjeologjike e zonës së fabrikes


3.6.Relievi

Rajoni i gjerë i Fabrikes se pet Koksit me deponin e koksit “Lab Oil” ” karakterizohet me një relief të ulët kodrinorë –malore si pjesë jugore e regjionit te Prishtines , gjegjësisht maleve të zhegovcit në lindje . Lartesia me e larte është maja e Shashkovcit 978m kurse me e ulëta në kuotën k.542m e ashtuqujtura Suhodoll.

3.7. Pedologjia

Në aspektin pedologjik , toka ku ndodhet fabrik e pet koksit dhe deponin e koksit dhe objektet tjera përcjellëse bënë pjesë në tokat e pazhvilluara , me një shtresë të humusit jashtëzakonisht të hollë. Lokacioni ku shtrihet mihja sipërfaqësore është tokë më ngjyrë kafeje me ph është bazike deri në neutrale sepse nuk kemi materie dhe shkëmbinjtë acidik. Përbërje ma të madhe të tokave kemi me ngjyrë kafe e ma pak ato të smonicës .Tokat me ngjyrë kafe janë biologjikisht mjaft aktive, smonice të cilat kryesisht përdoren përdorën për bujqësi. Masivet shkëmbore ne lindje dhe ne perendim rreth 2 km prej fabrikes janë kryesisht të familjes së rreshpeve dhe gëlqerorë, serpentinite , amfibole , në të cilën vetëm andezitet perdoren si material per ndertimtari dhe asfalt betone.Ne ngastrat ku jane te venosura fabrika e pet koksit dhe deponia e petkosit eshte tokë smonice e pakarbonizuar

(70)



Legjenda

70- Smonice e pakarbonizuar

Fig.8.Harta pedalogjike e zonës së fabrikës

3.8 Natyra dhe biodiversiteti

Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës , nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë lokalitet kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë/territor që është potencial të futet nën mbrojtje .

3.9. Flora dhe Fauna

Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve bimore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore. Mirëpo në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrethin të zonës ku realizohet projekti kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore, kulturat bujqësore, perimet, kurse ne lokacionin më të gjer bimësi drusore si qarri, bungu, kaça, murrizi, mana, manaferra, kurse ngastrat ku gjendet baza e pet koksit më herët kanë qenë të mbjellura me të lashta periodike bujqësore e pastaj djerrin, për shkak të pozitës gjeografike.

Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve shtazore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore në këtë domen. Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit, e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në rrethin të zonës e posaçërisht jashtë qytetit ne fshatrat për rreth përpos kafshëve dhe shpendëve shtëpiake, jetojnë edhe gjitarët , zvarranikët , brejtësit , insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, derri i egër, iriqi etj. Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: bilbilat, thëllënëza e fushës, sorrat , shqiponja , etj.

3.10. Dukshmëria

Shikuar nga pozita, ku është e vendosur fabrika e pet koksit dukshmëria është mjaft e lartë në të gjitha drejtimet. Ky rajon është i mbuluar nga mjegullat e hershme pranverore dhe vjeshtore .

3.11. Peizazhi

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin fabrika e pet koksit mjedisi. Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive .

Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

Projekti i lartë shënuar ne fabriken e pet koksit nuk ka ndonjë ndikim negativ në prishjen e peizazhit në lokacionin e analizuar, sepse ky lokacion është shëndrruar ne zonë industriale dhe syri i njeriut është mësuar me këte gjendje të objekteve afariste dhe industriale.

3.12. Ajri

Edhe pse ne rrethin të këtij lokacioni deri tani nuk janë bërë matje mbi shkallën e ndotjes së ajrit ,ujit, tokës dhe zhurmës në mënyrë që të bëhet një vlerësim sa më preciz i gjendjes mjedisore për lokacionin ku ndodhet fabrika e betornit. Nga vet konfiguracioni i terenit dhe funksionimi i aktiviteteve industriale, ne rrethin dhe gjithashtu objektet industriale që janë duke u ndërtuar përgjatë magjistrales ndikojnë në ndotjen e ajrit, fregvenca e madhe e automjeteve në rrugën magjistrale Prishtine –Ferizaj , Prishtine -Lipjan , gjegjësisht ndikojnë në ndotjen e ajrit gjithashtu ne ndotjen e ajrit ndikojnë dhe pajimet agro teknike të cilat nevojiten për kryerjen e punëve bujqësore, mund të konkludojm se ndotja e ajrit në këtë regjion është e konsiderueshme.

3.13. Uji

Ndotja e ujit shkaktohet nga objektet industriale të lartcekura, ndotja e ujit shkaktohet edhe nga fabrika e pet koksit dhe deponia e pet koksit të cilat janë të vendosura ne anët e rrugës magjistrale. Ndotja e ujit shkaktohet dhe nga ujërat e zeza të cilat shkarkohen nga komuniteti ne recipient të pa trajtuara. Ndotja e ujit pjesërisht shkaktohet nga trafiku i cili

zhvillohet në rrugën magjistrale Ferizaj – Prishtinë, dhe nga shpërlërja e trasës së rrugës me të reshurat atmosferike.

4.0. Fabrika e prodhimit të Pet Koksit dhe deponia e pet koksit në Preoc-Graçanice e shpk” Lab-OIL” Prishtinë



Fig.9. Fabrika Pet Kokut / Preoc-Graçanicë

4.1. Përshkrimi i procesit teknologjik të prodhimit të Pet Koksit dhe deponia e pet koksit


Pet koku është materie e ngurtë, vjen në formë të pa kalcinuar (Refuz) i papërpunuar dhe në fabrikë e përpunojnë duke e grimcuar deri në mikronë për ti furnizuar klientët.

Së pari, materiali i pa bluar i peti koksit futet në thyerës, bunkerin pranues, i cili ka një kapacitet diku 15 ton në orë për bluarje, koksi gjendet në depo apo në sektorin e parë dhe aty thyhet deri në 1 cm, pastaj me anë të shiritit transportues bartet deri tek sektori i tharje apo reparti i dytë, aty me anë të elevatorëve bartet tek tubi ku gjendet tharësi, aty kalon thahet dhe pastaj kalon prapë në thyerës ku grimcohet prapë deri në 0.5 mm.

Nga aty pastaj bartet prapë me anë të kërmijve transportues deri tek mullinjtë kryesorë, të cilët kanë një kapacitet prej 5 ton në orë, aty gjinden kater mullinjtë në të dy linjat ku prapë bëhet bluarja finale, grimca më e madhe nuk duhet të jetë mbi 0.9 mikronë dhe lagështia e materialit të finalizuar nuk duhet të jetë mbi 0.90-1 %.

Materiali i grimcuar barten në gjashte siloset me anë të presionit të ajrit përmes tubave fi-90 dhe prej aty ngarkohet në kamionë dhe transportohet tek klientët.

Fabrika e petkoksit të shpërndarë "Lab-oil" Prishtinë, është e organizuar në dy linja të prodhimit. Me gjashte silos dhe bunkerin pranues të termueses kryesore. Ky organizim i operimit është i paraqitur në skemën e prerjes horizontale të projektimit të objekteve që operojnë deri në prodhimin final të petkoksit.



Outdoor cabinet	
object	power
chufe	4 kW
band conveyor	7.5 kW
metal detector	3 kW
basket elevator	4 kW
hammer mill	55 kW
air filter	7.5 kW
rotary valve	2 kW
screw conveyor	2x3 kW
sum	103.5 kW

LEGJENDA

1. Bunkeri
2. Shiriti Transportues
3. Elevatorët
4. Thyerësi
5. Tharësi
6. Kërmijtë
7. Komanda kryesore
8. Mullinjtë
9. Filtërat
10. Sendofari
11. Siloset
12. Bombola e Gazit

Kabineti i brendshëm	
object	power
chufe	4 kW
screw conveyor	2x3 kW
rotary valve	0.75 kW
screw conveyor	3 kW
mill	250 kW
through auger	3 kW
rotary valve	0.75 kW
fan	45 kW
compressor	75 kW
dryer	7.5 kW
sum	395 kW

Agon Bahtiri
Inxhinier i Fabrikës
Lab-Oil Sh.p.k.

Vija e pare




Fig.10 Skema e procesit të thyerjes dhe thërmimit të pet koksit vija e parë dhe e dytë

Lnja e 1

Bunkeri

Gjendet në pjesën e depos, ku prej aty edhe fillon procesi i thërrmimit apo bluarjes së materialit.

Bunkeri ngarkohet me pet koks, me anë të ngarkuesit nga punëtori i cili punon në sektorin e para-thyerjes.

Bunkeri ka një kapacitet prej 4 tona, pjesë shtesë ka vibratorin i cili me anë të një komande elektronike lëshohet kohë pas kohe për ta shkarkuar materialin i i cili gjendet në bunker.

Materiali që futet në bunker në vete mban një lagështi diku prej 4-9%.



Foto.1 Bunkeri

Shiriti Transportues

Në fabrikë gjenden tre shirita të cilët e bëjnë bartjen e materialit.

Elementet kryesore të shiritit janë:



Shiriti prej materialit të gumës, (përbëhet prej dy tamburave me diametër 30 cm dhe gjerësi 60cm) gjithashtu si pjesë kryesore janë rulet ku nëpër to qarkullon shiriti prej gume.

Elektromotorët të cilët i fusin në funksion shiritat janë nga 4.5 kw, 3 kw.

Foto 2. Shiriti transportues



Foto 3. Elevatori

Elevatorët

Bëjnë bartjen e koksit me anë të kovave me dimensione 30cm dhe thellësi 20cm të cilat janë të vendosura në shiritin e gumës, janë të vendosur dy tambura në të cilët rrotullohet shiriti.

Elektromotori i cili i vë punë elevatorët ka kapacitet prej 5 KW ku prej aty materiali bartet tek tharësi.




Foto 4. Thyerësi

Thyerësi

Në repartet e fabrikës gjenden dy copëtues të koksit. I pari është i vendosur ne sektorin e depos dhe kryesisht bënë copëtimin e koksit deri ne 2-3cm, pastaj me anë të shiritave transportues kalon tek thyerësi i dytë, ku aty bëhet imtësimi prej 0.5-1cm, pastaj kalon në mullinjtë kryesor dhe aty bëhet mikronizimi final.

Elektromotori në vete përmban fuqi prej 35 KW.

Tharësi

Në fabrikë gjenden dy tharëse, njëra është aktive çdo here gjatë procesit të punës, ndërsa tjetra është rezervë dhe përdoret gjatë kohës së dimrit për një periudhë shumë të shkurtër. Lënda djegëse është Gazi, rëndësia e tij është shumë e madhe sepse shërben për tharjen e materialit, i cili në vete përmban një sasi të konsiderueshme të lagështisë ku në gjatë procesit të punës arrijmë të bëjmë tharjen aq sa parashikohet.



Foto 5. Tharësi

Tharësi përbëhet prej valvuleve dhe ventileve sigures, prej tre normave të cilat tregojnë gjendjen e sigurisë së tij dhe rritjen e temperaturës gjatë procesit të punës.



Foto 6. Kërmijtë

Janë disa kërmij në fabrikë me dimensione të ndryshme, roli kryesor i tyre është bartja apo transportimi i pet koksit.

Zakonisht janë të vendosur para për ta futurë materialin te mullinjtë.

Foto.7. Komanda kryesore



Komanda kryesore është e paraqitur në ekran dhe nga aty bëhet lëshimi i komplet makinerisë në punë, janë të instaluar “sensorë” nëse ka ndonjë bllokim apo ndalës e çfarë do lloji.

Në ekran janë të ndara sektorët e makinerisë, duke filluar nga depoja apo sektori i pare, pjesa e dytë po tek tharja dhe pjesa e tretë apo finalja tek komanda, ku

nga aty komandohet krejt linja e prodhimit të pet koksit.

Komandën e menaxhon inxhinieri i fabrikës apo përgjegjësi i ndërrimit.



Foto 8. Mullinjtë

Janë nga dy mullinj kryesor per linje , që kanë kapacitet rreth 10 ton në orë, së bashku arrijnë kapacitetin prej 20 ton.

Elektromotori ka kapacitet 315 KW, me 1500 rrotullime në 1 minutë.

Pesha komplet me bazament është diku 13 Ton. Mullinjtë kanë diametër diku 1.5

metër, ku në të janë të inkuadruar 6 pllaka 80x60 në formë harkore, ku në secilën pllakë vendosen 96 pllakëza me dimensione 100x275 dhe 48 pllaka me dimensione 100x115.

Janë të vendosura dy kushineta lartë 1226 M dhe poshtë 6328 M/C3.

Përbehet prej 30 “gishtave” ku roli i tyre është kthimi i materialit në ri-bluarje.



Filtërat

Materiali i mikronizuar, i cili imtësohet në mullirin kryesor dhe me anë të ventilatorit me një kapacitet 35 KW tërhiqet dhe futet Brenda në filtër.

Ka të vendosur pajisjen elektronike “frekuenceatorin” që e bënë rregullimin e ajrit.

Kapaciteti i filtërit është afërisht 4 ton, brenda në filtër janë të vendosur 225 filtëra të cilët kanë rezistencë nga djegia dhe nuk e lejojnë të del pluhurin në ambientin e jashtëm.

Foto 9. Filterat

Sendofari

Materiali i mikronizuar i cili imtësohet në mullinjtë kryesor dhe me anë të kërmijëve bëhet



bartja deri te kjo pajisje grumbulluese. Specifik e veçantë është se sendofari përbëhet nga një ekran digjital dhe disa valvula, ventila, barometra të cilët komandohen me anë të kohës që është i programuar varësisht prej sasisë së materialit.

Kapaciteti i tij është maksimumi 700 kg dhe në momentin që ngarkohet sensori i jep alarmin komandës dhe fillon shkarkimi deri në sillosa, me një presion 2 bar dhe një largësi diku 25 metra gjatësi.

Foto 10. Sendofari



Siloset


Në total janë gjashte silose me kapacitet për secilin nga 50 Ton.

Në pjesën e sipërme të siloseve janë të vendosur ventilatorët. Brenda në çdo silos gjenden nga katër filtëra me dimension fi. 20 me gjatësi 1 metër.

Roli kryesor i tyre është mos lejimi i daljes së pluhurit në ambientin e jashtëm.

Në pjesën e poshtme bëhet ngarkimi i kamionëve me koks të mikronizuar, shkarkimi bëhet me ventila pneumatik dhe me anë të komandave elektrike

Foto 11. Siloset



Bombola e Gazit


Bombola e gazit është e vendosur në pjesën e jashtme të objektit, sasia për mbushjen me gaz është rreth 10 Ton, është e pajisur me ventil të sigurisë, kaldajën elektrike e cila ja humb lagështin gazit gjatë procesit të punës, ventileve mekanik të cilët e mbyllin në mënyrë hermetike daljen e gazit në ambientin e jashtëm.

Ka orën matëse ku tregon se çfarë sasia e gazit shpenzohet në metër kub në orë.

Foto 12. Bombola e gazit

4.2. Koncepti prodhues i fabrikes se peti koksit (Prerja vertikale e vijave të prodhimit të Pet koksit)

PRERJE A-A



LEGJENA

1. BUNKER 3 ton
2. TRANSPORTUES 4m
3. ELEVATOR
4. COPTUES
5. ELEVATOR
6. FURRË THARRËSE Ø=1.2m X 15m
7. DËJEGËS Q5/2 225-1250 kw
8. ELEVATOR
9. CIKLON
10. FILTER DMC 64
11. BUNKER PRITËS 10 ton
12. SHËNEKU TRANSPORTUES
13. MULLIRI "MTW 175 Z"
14. TUB Ø=300mm për ajër të ngrohje
15. VENTILATOR 220 kw
16. CIKLONA Ø=2m
17. FILTER DMC 250
18. SHËNEKU TRANSPORTUES (egzistues, nga silloset e Suharekes)
19. CENTRIFIRE (model i ri, me i madh nga egzistuesi)
20. RESIVER AJRI 2000L
21. KANAL I TUBAVE PNEUMATIK
22. TUBACION PNEUMATIK
23. SILLOS 2 x 100 ton
24. PULTI I KOMANDIMIT
25. DALJET EMERGJENTE

PROJEKT TEKNOLOGJIK

Objekti: PFC Inovacioni Shkencor
Lokacioni: Prishtinë, R. Kosovës
Investitori: Lubi QJ

Projekti
FABRIKA E BLUARJES SE
KOKSIT TE NAFITES "MTW 175Z"

Emertimi i Fildes
PLANI / PRERJA E VJES TEKNOLOGJIKE

STAFI I PROJEKTIMIT
Drejtori projekti: Ing.Dr. Neli, Vendi Shkencor
Teknologji: Ing.Dr. Neli, Vendi Shkencor

Ing. D. Neli, Zef Gashi
Klar. Ark. Agim Gashi
Klar. Ark. Agim Gashi
Ark. Gerdash Ballo
Ark. Shpresa Rambo
Ark. Shpresa Rambo

Shkalla e vizimit: 1:.....
Data: Dhjetor, 2022

Nr.
A-02

Linja e dyte e prodhimit të pet koksit

Gjendet në pjesën e depos ku prej aty edhe fillon procesi i thërrmimit apo bluarjes së materialit.



Bunkeri ngarkohet me pet koks me anë të fadromes apo bagerit nga punëtori I cili punon në sektorin e deponisë.

Bunkeri ka një kapacitet prej 4 Tona, pjesë inkuadruese e ka edhe një vibrator cili me anë të një komande elektornike lëshohet kohë pas kohe për ta shkarkua materialin i cili gjendet në bunker.

Foto 13. Bunkeri pranues i petikoksit



Bunkeri i mullirit ka kapacitet 7 ton dhe shërben si rezervuar i materialit para bluarjes. Poshtë bunkerit gjendet një kërmill shpejtësia e të cili komandohet nga operatori dhe mundëson që në mulli të futet sasia e nevojshme e materialit.

Kërmilli i bunkerit ka motor 3.5kw dhe kapacitet deri 15 ton/h.

Foto 14. Bunkeri i mullirit



Cikloni me diametër 1.3 metra bën ndarjen e ajrit që krijon ventilatori i mullirit dhe materialin e mikronizuar që vjen me të.

Vorbulla e ajrit që krijohet në ciklone si pasojë e formës konike të tij bën që materiali të bie poshtë drejt kermillave nën cikloneve për tu transportuar drejt pneumotransportuesit, kurse ajri shkon lart për tu futar prap në mulli për të vazhduar përsëri i njëjti cikël.

Foto 15. Cikloni



Thyresi

Copëtuesi bën thyerjen e koksit deri në 1-2 cm, pastaj me anë të kërmillit që gjendet nën copëtues siç shihet edhe në foto materiali i thyer bartet tek elevatorët.

Copëtuesi ka elektromotorr me 45 kw fuqi dhe kapaciteti i tij është rreth 18 ton/h.

Foto 16.Thyresi



Përmes fotos më lart kemi paraqitur djegësin me gaz propan, ky djegës mundëson temperaturën e nevojshme për tharjen e koksit të naftës.

Tipi i djegësit është "WM-G10/3-A me fuqi nga 100 deri me 1000.

Foto 17. Djegesi me gas propan WM-G10/3-A



Elevatorët

Bëjnë bartjen e koksit me anë të kovave me dimensione 30cm dhe thellësi 20 cm të cilat janë të vendosura në singjirë të çeliktë të cilët orientohen nga dy rola metalike.

Elektromotori i cili i vë në punë elevatorët ka kapacitet prej 3.5 KW dhe kapaciteti i tyre shkon nga 10 deri në 15 tona për orë në vartësi nga gjendja e koksit.

Foto 18. Elevatori

Filtrat me thasë janë dy nga pajisjet kyqe për tharjen e materialit para dhe pas bluarjes.



Foto 19 Filtrat

Ata punojnë në vakum i cili krijohet nga ventilatorët që tërheqin ajrin nga filtri, kështu që tërheqin nga materiali lagështinë përmes avullit që krijohet nga temperatura që ka krijuar furra tharëse ose mulliri gjatë bluarjes.

Në total filtri ka 256 thasë që shkunden me ajër nga elektroventilat, duke ndarë kështu pluhurin nga ajri dhe avulli.

Ajri i pastër dhe Avulli dalin jashtë në natyrë, kurse pluhuri futet prapë në silose ose në mulli për bluarje.

Pajisja në foton më lart është furrë tharëse, gjatësia e saj është 13 metra dhe diametri 1.2 metra kurse kapaciteti i saj është rreth 13 ton/h.



Foto 20. Furre tharëse

Në trupin e furrës nga ana e brendshme janë të vendosura disa lopata që gjatë rrotullimit të sajë ato përcjellin materialin nga njëra tek tjetra duke bërë që vazhdimisht materiali të ecën përpara.

Materiali në furrën e nxehtë nga djegësi me gaz propan thahet gjatë rrugës që bën nga pika hyrëse e deri në dalje e cila rrugë zgjat rreth 20 minuta. Pra furra në të njëjtën kohë transporton dhe e than materialin në këtë rast Koxin e Naftës.



Foto 21. Mulliri i tipit "MTW175Z"

Në foton më lart shihet Mulliri I tipit "MTW175Z" me kapacitet prej 7 deri në 15 tona/h në vartësi të materialit që bluan.

Mulliri e bën bluarjen me anë të ruleve të çelikut të cilat koksin e naftës e shtypin me unazën ku rrotullohen.

Mulliri në pjesën e sipërme ka përzgjedhësin i cili ndan grimcat e koksit në baze të granulës të cilën e përcakton operatori. Granula mund të variojë nga 0.1 deri në 0,9 mikron.



Foto 22. Rezervuari i ajrit

Rezervuari i ajrit të komprimuar ka kapacitet prej 2000 L dhe mundëson rezervimin e ajrit për pajisjet të cilat punojnë me ajër të komprimuar.

Gjithashtu ky rezervuar bën që kompresorët të punojnë më rrallë duke kursyer kështu energji elektrike.



Foto 23. Sendofari

Sendofari- Materiali i mikronizuar i cili imtësohet në mullinjtë kryesor dhe me anë të kërmillëve bëhet bartja deri te kjo pajisje grumbulluese. Specifik e veçante është se sendofari përbëhet nga një ekran digjital dhe disa valvola, ventila, barometra të cilët komandohen me anë të kohës që është i programuar dhe varësitë prej sasisë së materialit. Kapaciteti i tij është maksimumi 700 kg dhe në momentin që ngarkohet censoredi i jep alarmin komandës dhe fillon shkarkimi deri në silose me një presion 2 bar dhe një largësi diku 25 metra gjatësi.



Foto 24. Shiriti Transportues

Shiriti Transportues i cili është prej materialit të gumës, prej dy tamburave me diametër 25 cm dhe gjerësi 70cm, gjithashtu si pjesë kryesore janë rulet ku nëpër të qarkullon shiriti prej gume. Elektromotorët të cilët i fusin në funksion shiritat janë nga 4.5 kw, 3 kw.



Foto 25 Ventilatori i Filtrit

Ventilatori i Filtrit të mullirit mundëson krijimin e vakumit që nevojitet në mënyrë që mos të dal pluhur gjatë bluarjes në mulli, njëkohësisht nxjerr edhe avullin dhe ajrin nga filtri dhe mulliri.



Foto 26 Ventilatori i mullirit

Ventilatori i Mullirit rrotullohet nga një motor me fuqi 220 kw dhe gjeneron 1490 rrotullime në minutë. Roli tij është krijimi i shtypjes së ajrit në mulli që materialin e bluar ta transportoj drejt cikloneve.



Foto 27. Yllëzat rrotulluese

Yllëzat rrotulluese janë pjesë e pajisjeve transportuese në fabrikë, të cilat mundësojnë kalimin e materialit pa lejuar që bashkë me të kaloj edhe ajri, duke shmangur mundësin për humbjen e nxehtësisë. Kapaciteti transportues i tyre është 10 deri në 15 ton/h dhe punon me motor 1.5 kw.



Foto 28. Deponia e pet koksit

Deponia e pet koksit , është pjesë e ngastrave ku është deponuar materiali i pet koksit të përpunuar

Kanali i grumbullimit të ujrave sipërfaqësore , derdhet në pusetat sedimentuese.

4.2 Komponentët hyrëse në procesin e aktiviteteve në fabriken e pet kokut dhe deponise se pet kokut.

Komponentët hyrëse në procesin e aktiviteteve që zhvillohen në kompleksin e deponisë të karburanteve janë:

- Pet koku ne gjendje te ngurtë, pa kalcinuar (Refuz) i papërpunuar
- Energjia elektrike.
- Uji

Pet koku është materie e ngurtë, vjen në formë të pa kalcinuar (Refuz) i papërpunuar, pas perpunimit , thermimit sherben per furnizim te klienteve.

Karburantet dhe ate si lëndë djegëse nafta dhe benzina shërbenë për furnizimin e automjeteve, për nevoja ne amvisni ne industri etj.

Energjia elektrike shërben për ndriçim dhe funksionim të pajisjeve si dhe për nxehje.

Furnizimi me energji elektrike bëhet nga rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike, nëpër mes trafostacionit që është pronë e kompanisë.

Uji shfrytëzohet për qëllime sanitare ,për larjen e platosë së deponis të karburanteve dhe për furnizim të pajisjeve kundër zjarrit.

Nevojat e ujit për sanitari varet nga numri i punëtorëve p.sh për një punëtor nevojiten 25 lit. ujë/ditë. Furnizimi me ujë në kompleksin e depos bëhet nga ujësjellësi i qytetit, uji i cili shfrytëzohet kryesisht për larje të pllatosë si dhe ujitjen e sipërfaqeve të gjelbëruara, dhe për mbushjen e rezervarit për mbajtjen e ujit rezervë për furnizim të pajisjeve kundër zjarrit .

4.3. Komponentët dalëse në procesin e aktiviteteve ne fabriken e pet kokut dhe deponise

Komponentët dalëse nga procesi i aktiviteteve që zhvillohen në kompleksin e fabrikes se pet kokut deponise janë :

- Petkoku i mikronizuar
- Ujërat e ndotura.
- Avujt i hidrokarbureve dhe gazrat shkarkuese nga autocisternet.
- Zhurma.
- Mbeturinat e ngurta.

5. Identifikimi dhe Përshkrimi i Ndikimeve të Mundshme në Mjedis

5.1. Ndikimet në ajër

Në aktivitetin e prodhimit të peti koksit, deponis, ndikime negative paraqiten në ambientin e ajrit dhe atë:

Nga procesi teknologjik për prodhimin e peti koksit nga ku lirohen grimcat e pluhurit të koksit, dhe grimcat e pluhurit nga fraksionet e agregatit që përdoret për prodhimin e fraksioneve të koksit, grimcat e pluhurave të cilat gravitojnë për shkak të peshës së tyre në drejtim të tokës, dhe depozitohen në afërsi të fabrikes, pluhurat kanë përbërje të elementeve kimike që posedon koksi dhe vetë lënda minerale, pluhurat të cilat i bartë ajri për shkak të reliefit dhe kushteve tjera mjedisore gravitojnë në distanca më të largëta, kjo situatë e përshkruar, kishte me qenë pa përdorimin e masave për zvogëlimin e pluhurit. Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirimimit të pluhurit gjatë zbrazjes së koksit me granulime me të medhaja nga auto cisternat dhe mbushja e bunkerit për të transportuar deri tek mullijt bluarese, gjatë sjelljes së koksit nga mjeti transportues deri në depon për therrim, nga mundësia e lirimimit të pluhurit të koksit drejtpërdrejt nga vendet lidhëse të gypave përcjellës (transportues) të koksit, nga mundësia e lirimimit të pluhurit nga sipërfaqet manipuluese. Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirimimit të gazrave nga automjetet e transportit dhe automjeteve tjera të rënda që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e koksit. Gazrat nga djegëjet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotës me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NO_x, HxCy, SO₂ dhe Pb.

5.2. Ndikimet në tokë

Në aktivitetin e prodhimit të pet koksit dhe fraksioneve nga koksit, ndikime negative në mjedis paraqiten në tokë dhe atë:

Ndikimet negative nga mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmave, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët.

Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura në pasusin e sipërm (ndikimet në ajër), si dhe ngjeshjen e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese.

Ndikim tjetër me rënësi në tokë paraqitet edhe nga deponimi i fraksioneve të agregateve si dhe depozitimi i pluhurit nga këto fraksione.

Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe ndërrimit të tyre, gjatë pëlcitjes të gypave hidraulik të mjeteve punuese. Ndikimet nga mbeturinat e ngurta dhe lëngëta që krijohen nga larja e makinave prodhuese, auto-mikserëve, dhe automjetet tjera transportuese.

5.3. Ndikimet në ujë

Ndikime negative në ujë shkaktohen:

Nga derivatet , vajrat dhe yndyrat (lyersit) e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat prodhuese dhe tjera të cekura në pasuset e më sipërm me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe ndotjen e ujërave nëntokësore.

Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili mund të bartet me anë të ujërave sipërfaqësore.

Ndikime negative në ujëra nëntokësore mund të ndikojnë deponimi i pet koksit në sipërfaqe të pa mbuluara.

